



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 17.12.2014, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. *(2 iniciativa)*
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar. *(shqyrtimi nen për nen)*

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Armando Prenga, Mark Frroku, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Tom Doshi, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Bledi Çuçi – ministër i Shtetit për Çështjet Vendore.

Erisa Proko – këshilltare e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore.

Eduard Ahmeti – drejtor i Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ermonela Felaj – ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Rovena Voda – shefe kabineti e ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Pranvera Behushi – drejtoreshë juridike në Ministrinë e Brendshme.

Albana Koçiu – drejtoreshë e Departamentit të Administratës Publike.

Enkelejd Lamaj – jurist i Departamentit Juridik në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit, meqenëse kuorumi është i realizuar.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Në fakt, së bashku me këtë projektligj është edhe një nismë e një grupi deputetësh që daton nga muaji gusht, por meqenëse kjo nismë është thithur, është pjesë e nismës së re të sjellë nga Këshilli i Ministrave edhe në konsultim me ekspertët ndërkombëtarë, do të shqyrtohen së bashku dhe në fund fare do të kemi një qëndrim dhe një tekst të integruar.

Për të paraqitur projektligjin dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të mundshme ose komenteve të deputetëve lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji, të cilin do ta diskutojmë dhe do ta miratojmë sot në parim, është prezent ministri, zoti Bledi Çuçi.

Faleminderit, zoti Ministër!

Projektligji është i njohur për kolegët deputetë, por është në interes të procedurës dhe të transparencës me publikun që të paraqisni një ekspozë të shkurtër lidhur me përmbajtjen dhe risitë e këtij projektligji, sidomos edhe me procesin e konsultimit që keni pasur me partnerët.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Bledi Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, sot po ju paraqesim një grup amendimesh që lidhen me ligjin e prokurimit publik, i ardhur si rezultat i nevojës për të përsosur sa më shumë rregullat, duke krijuar kushtet e duhura për mirëfunksionimin e procedurave përzgjedhëse të prokurimit me objektivin e miradministrit të fondeve publike dhe të shpenzimeve të qeverisë, por jo vetëm.

Amendimet vijnë me qëllim që të kemi një sistem të përgjegjshëm, efektiv dhe transparent të mirëpërdorimit të fondeve publike, që të bëjmë një përafrim të mëtejshëm të legjislacionit të prokurimit publik me *Acquis*-në në fuqi të prokurimit publik dhe për këtë qëllim, siç e keni edhe përpara, projektligji shoqërohet me tabelën e përputhshmërisë me direktivën 18/2004 të Komisionit European dhe të Parlamentit European, të miratuar në Këshill në datën 31 mars të vitit 2004, e cila ka për qëllim rritjen e mëtejshme të efikasitetit në procedurat e prokurimit publik dhe nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj në procedurat e prokurimit publik.

Së fundi, ka si qëllim përmirësimin e përmbajtjes, e cila u është përshtatur më mirë normave të sotme të teknikës legislative. Pra, të gjitha këto mangësi të cilat janë vënë re gjatë këtyre viteve të aplikimit apo të zbatimit të ligjit të prokurimit publik dhe në mënyrë të përmbledhur, i kemi sjellë sot në formën e amendimeve.

Dua t'ju them se amendimet vijnë pas një konsultimi të gjerë që ne kemi bërë me ekspertët e SIGMA-s. SIGMA në këtë rast luan rolin e organizatës e cila filtron të gjitha standardet që ka Bashkimi European në lidhje me rregullat e prokurimit publik. Kështu që mendoj se është e plotë edhe si nismë legislative, sepse ndoshta për herë të parë çdo nen ka në krah edhe mendimin e ekspertëve të SIGMA-s dhe miratimin, nëse janë dakord ose kundër, sugjerimet dhe në fund të fundit dakordësinë me këtë institucion kaq të rëndësishëm që në njëfarë mënyre është filtri i Brukselit për ligjin e prokurimit publik.

Në mënyrë specifike, në qoftë se doni të shkoni nen për nen, mund t'ju them se ka të bëjë me forcimin e Komisionit të Prokurimit Publik, duke parë edhe mangësinë në marrjen e vendimeve të Komisionit dhe meqenëse ajo është një *quasi*-gjykatë, kemi gjykuar që anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik të jenë juristë me profesion, pasi kanë të bëjnë me gjykimin e procedurave. Kjo është një nga risitë. Ka të bëjë me unifikimin e procedurave që do të ndiqen për prokurimet publike për shërbime, të cilat nuk mund të parashikohen që në fillim të vitit në sasi dhe në vlerë monetare, duke përdorur dhe duke hapur rrugën për t'u përdorur gjerësisht ajo që quhet marrëveshja kuadër. Edhe kjo është një risi, pasi në këtë pikë bëjmë edhe një lloj harmonizimi me shqetësimin që kanë pasur deputetët në propozimin e tyre për disa ndryshime që lidhen pikërisht me këtë aspekt të prokurimit publik.

Mendojmë se është harmonizuar dhe gjen shprehje edhe në amendimet tona dhe në këtë mënyrë shmanget plotësisht handikapi që ishte krijuar pikërisht nga këto boshllëqe.

Gjithashtu, kemi pasur parasysh që për konkursat e projektimit vlera specifike që merr vlera monetare të zbehet dhe t'i jepet më shumë rëndësi cilësisë së projektimit, sepse kjo është edhe në praktikën më të mirë të Bashkimit European, që për konkursat e projektimit nuk mund të jetë 100% fokusi te çmimi, por te cilësia e projektimit.

Janë bërë disa ndryshime të teknikës legislative. Ka një ndryshim të rëndësishëm për sa i përket parandalimit të ofertave, që quhen anomalish të ulëta, pasi kanë qenë vazhdimisht pengesë nëpër entet publike që bëjnë prokurime publike. Shumë operatorë, me qëllim abuzimi, sillnin oferta, që në kuptimin e ligjit quhen anomalish të ulëta, duke ulur ndjeshëm cilësinë dhe duke zvarritur pa fund procedurat e prokurimit publik. Për këtë gjë kemi bërë një ndërhyrje për të parandaluar pikërisht këtë fluks të ofertave anomalish të ulëta.

Sigurimi i ofertës, si një nga masat që më shumë ishin administrative dhe kthehej në një problem pastaj për ofertuesit, është menduar të hiqet, pra nuk ka më arsye të bëhet një sigurim oferte. Duke shtrënguar më shumë procedurat e prokurimit publik, tashmë sigurimi i ofertës është bërë i pavlefshëm duke ditur se edhe sigurimi i ofertës bëhej më shumë në mënyrë fiktive sesa në mënyrë reale.

Opsioni për sigurimin e ofertës është lënë për prokurimet në kufirin më të lartë sesa kufiri i lartë monetar që është pjesë e procedurës për kufirin për tenderët.

Këto janë pak a shumë ndryshimet. Gjithsesi, prezentë janë edhe ekspertët që kanë punuar në mënyrë specifike me ndryshimet. Kështu që në qoftë se keni ndonjë pyetje apo diskutim dhe doni komentet tona, jemi të hapur për t'i dhënë ato.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër, zoti Çuçi!

Me ministrin bashkë, janë të pranishëm: këshilltarja e ministrit, zonja Erisa Proko, dhe zoti Eduard Ahmeti, drejtor i Agjencisë së Prokurimit Publik.

Fjalën e ka relatori, zoti Blendi Klosi!

Blendi Klosi - Faleminderit, zoti kryetar!

Duke qenë dakord me ato që tha ministri, desha të shpreh nderin, që jam për herë të parë relator në këtë komision dhe të vlerësoj këtë projektligj të paraqitur nga qeveria, si dhe projektligjin e paraqitur nga një grup deputetësh.

Mendoj se projektligji është me karakter të fortë teknik dhe zgjidh në mënyrë korrekte një sërë problemesh, që janë shfaqur gjatë gjithë kësaj kohe të zbatimit të këtij ligji, që nga miratimi i tij. Duke parë me kujdes materialin e paraqitur, duke analizuar së bashku me stafin teknik të komisionit dhe përfaqësuesit e ministrisë, çdo amendament të paraqitur, them se projektligji është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, gjithashtu, është në përputhje me qëllimin tonë: të përmirësojmë dhe të thjeshtojmë procedurat e prokurimit publik, për të lehtësuar sa më shumë ndërmarrjet vepruese dhe për të zvogëluar sa më shumë hapësirat për korrupsion.

Po ashtu, shprehem dakord me qëndrimin e ministrit për projektin e paraqitur nga një grup deputetësh, dhe mendoj se ai gjen harmonizim në projektin e ardhur nga qeveria dhe mendoj se ka ardhur çasti që ai të realizohet, sepse është shqetësimi i deputetëve. Kemi kështu një projektligj, i cili duke përmbushur kriteret teknike dhe parimet ligjore, mendoj të kalojë nga komisioni ynë si komision për dhënie mendimi, për t'ia lënë vendimin e fundit komisionit përgjegjës, që është Komisioni i Ekonomisë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Klosi!

Kush ka pyetje?

Zoti Subashi, keni fjalën!

Armando Subashi - Faleminderit, zoti kryetar!

Desha të bëj një pyetje, duke e sjellë në formën e një shqetësimi. Sigurisht, nuk është se ne prokurojmë, sepse nuk na lidh detyra me këtë, por të them të drejtën, në shumë biseda që kemi pasur me shumë drejtues institucionesh, kryetarë komunash/bashkish, me ndryshimet që i janë bërë ligjit para 2-3 vjetësh, është parashikuar të ndiqen procedura prokurimi edhe për disa blerje të vogla, që shpesh janë të paparashikuara në disa institucione, por që mund të jenë defekte apo momente që ndodhin papritur në to dhe janë sjellë shembuj shumë kuptimplotë, fjala vjen, edhe për një llambë apo një bravë që prishet, duhet të bësh tender etj.

A janë sjellë ndryshime për ta përmirësuar këtë situatë dhe për ta bërë më fleksibël në këto institucione, sepse kështu siç është, nuk ka ndonjë përfitim edhe nga pikëpamja ekonomike dhe mund të përcaktohet një vlerë që edhe me një vlerë të caktuar në treg, të gjykohej dhe të vendosej shpejt?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Subashi!

Urdhëroni!

Blendi Çuçi – Çështjen e vlerës monetare, ligji ia ka deleguar KM-së. Ne kemi përfunduar vendimin e Këshillit të Ministrave, ku e kemi rritur këtë vlerë maksimale për shpenzimet rutinë, siç e përmendët ju, në mënyrë që operatorët dhe entet publike të jenë shumë më fleksibël në përdorimin e fondeve të tyre, në lidhje me këtë.

Ligji ia ka deleguar KM-së. Në mos gaboj, të mërkurën tjetër miratohet, pasi ka marrë mendimet e të gjitha institucioneve që kanë lidhje me këtë çështje (bëmë edhe konsultën me SIGMA-n) dhe te kjo VKM janë përcaktuar qartësisht nivelet që entet publike do të përdorin për procedurat e prokurimit të drejtpërdrejtë, kur është një vlerë e ulët dhe kështu me radhë, një kërkesë për propozim, që është edhe ajo e shkurtuar, nuk është një tender i hapur. Pikërisht, këto tavane i kemi rritur, duke pasqyruar edhe rritjen ekonomike sepse shqetësimi juaj dhe i të gjithë kryetarëve të enteve publike që prokurojnë fonde ka qenë i drejtë, sepse nuk janë të njëjta çmimet e vitit 2006 me çmimet që janë sot dhe me ato që do të jenë nesër. Kështu që është pasqyruar ky trend, ky zhvillim dhe kjo rritje çmimesh, edhe te tavanet që kemi ngritur pikërisht, për t'u dhënë mundësi këtyre enteve.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje tjetër? S'ka. Kush ka diskutime?

Me sa shoh, projekti qenka i qartë. Kolegët janë familjarizuar dhe ky nuk është nga ato projekte që ngjallin debat, siç ka ndodhur në komision dhe sa herë që kemi pasur çështje të tilla, s'kemi nguruar të debatojmë. Kjo tregon që është punuar me seriozitet nga qeveria dhe nga përfaqësuesit e asistencës.

Hedhim projektligjin në votim në parim!

Kush është dakord? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

E mbylлим këtu diskutimin për këtë projektligj për të vazhduar me projektligjin tjetër.

Faleminderit, zoti Ministër!

Falënderoj, zonjën Proko dhe zotin Ahmetaj!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 17.12.2014, ora 12:45

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Armando Prenga, Mark Frroku, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Tom Doshi, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Ermonela Felaj – ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.
Rovena Voda - drejtore e Kabinetit të ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.
Albana Koçiu - drejtoreshë e DAP-it.

Pranvera Behushi - drejtoreshë e Juridike, në Ministrinë e Brendshme.

Enkelejd Lamaj – jurist i Departamentit Juridik të INUK-ut.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, projekt i sjellë nga Këshilli i Ministrave.

Kemi bërë pyetje, diskutime dhe miratimin në parim. Tani kemi diskutimin nën për nën dhe votimin në tërësi. Fillojmë me nenin 1.

Neni 1. Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Për nenin 1 lidhur me titullimin. Sigurisht ky është një ligj që ndryshon ligjin “Për inspektimin e ndërtimit” dhe nuk besoj se ligji mbetet vetëm te ndërtimet e kundërligjshme. Është një objekt i ligjit. Inspektimi i ndërtimit ka një gamë shumë të gjerë, ndaj e gjej tërësisht të pavend që titullohet për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme. Por koncepti i mbrojtjes së territorit, që nuk ka qenë titulli i mëparshëm, se ka qenë thjesht inspektimi i ndërtimit, është tashmë i qartë dhe do të mjaftonte për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit. Territori mbrohet jo vetëm nga ndërtimet të paligjshme, por edhe nga mjaft elemente të tjera.

Kështu që ky titull i ri është një titull që e mbyll dhe nuk shkon me sferën e veprimtarisë së ligjit. Është një titullim më i ngushtë nga ç’është sfera e veprimit të ligjit, i cili është i gjerë në tërësinë e tij, se këtu kemi vetëm ndryshimin e disa neneve, por po të shikohet në mënyrë integrale ligji i cili do të jetë objekt i punës, ka dhe shumë punë të tjera të cilat janë përshkruar dhe në objektet më poshtë që e bëjnë këtë që të duket se i gjithë inspektimi në fushën e ndërtimit të kontrollit të territorit është vetëm për ndërtimet të kundërligjshme. Nuk është vetëm kjo, është një objekt, një çështje e caktuar që merr një qëndrim të ri në bazë të ndryshimeve që ka brenda, por nuk mund të identifikohet ligji me kundërligjshmërinë e tij. Kështu që propozimi im është që titulli i ligjit të jetë: “[Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit”.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka ministrja për propozimin e kolegut Vasili.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Në fakt ky është një propozim rishtas, të themi, sepse ne kemi marrë disa propozime të bëra nga Komisioni i Ligjeve në lidhje me ndryshimet që janë prezantuar nga Këshilli i Ministrave në ligjin “Për inspektimin e ndërtimit”. Unë do të doja të vija në vëmendje që fokusi i ligjit në fakt është ndërtimi. Kudo që ai ndodh është ndërtimi dhe diskutimin do ta kisha realisht për përdorimin e termit të kundërligjshëm apo të paligjshëm që ju na keni sugjeruar dhe e kam pasur këtë diskutim me veten dhe dua ta ndaj edhe me ju. Në vendimin e

Gjykatës Kushtetuese, dhe unë do t'i referohem specifikisht atij vendimi, kemi një interpretim të kundërligjshmërisë se çfarë nënkupton kundërligjshmëria. Është vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka marrë në referencë një VKM lidhur me unifikimin e kompetencave të inspektorateve, inspektoratit qendror dhe vendor në territor. Dhe Gjykata Kushtetuese, ndërsa ka bërë interpretimin e konceptit të kundërligjshmërisë, ka dhënë dhe çfarë nënkupton kundërligjshmëria e ndërtimeve sipas legjislacioneve të ndryshme.

Kundërligjshmëria. Gjykata thekson se nisur dhe nga koncepti i dhënë për të në legjislacionin shqiptar dhe atë të huaj kundërligjshmëria duhet të lidhet me rastet e ndërtimeve pa leje të miratuara nga organet kompetente ose me mosrespektimin, tejkalimin, ndryshimin të lejes së ndërtimit të dhënë nga autoritetet kompetente dhe jo me vlefshmërinë e lejes si akt administrativ. Pra, ideja është se në mendimin tonë dhe nga ajo çfarë jemi munduar të lexojmë gjatë kësaj kohe, kundërligjshmëria duket si koncept më i gjerë se sa paligjshmëria. Pra, në qoftë se paligjshmëria i referohet, po themi, ndërtimeve pa leje që bëhen pa ligj fare, kundërligjshmëria është pak më e gjerë, sepse në atë rast përdoret edhe ligji, por le të themi bëhet gjëja në mashtrim të ligjit. Dhe te këto ndryshime që kemi sjellë ne e implikojmë Inspektoratin Kombëtar në goditjen e lejeve në gjykatë që janë dhënë po themi nga autoriteti, nga kryetarët e bashkive. Duket që janë haptas në kundërshti me ligjin dhe në këtë rast ne i kemi dhënë të drejtë INUK-ut që këto leje ai të shkojë dhe t'ia ankimojë në gjykatë. Mundësi të tjera nuk ka për të ndërhyrë te ndërtimi, ose masa të tjera nuk mund të marrë, sepse nuk ia lejon ligji për shkak të parimit të decentralizimit dhe subsidiaritetit. Ky është shqetësimi, ky është problemi.

Fatmir Xhafaj – Kemi dy propozime. Kemi një propozim të bërë nga relatori, që titulli i ligjit të jetë: “Për inspektimin e mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme”, së cilës iu referove tani. Kemi dhe një propozim të dytë për ta bërë për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit. Do të shpreheni dhe për propozimin e zotit Vasili?

Ermonela Felaj – Unë mendoj se fokusi i ligjit janë ndërtimet. Nga fillimi në fund të ligjit flitet për ndërtimet dhe kam merak se duke thënë thjesht inspektim dhe mbrojtje territori do të kemi problemin e organit që është përgjegjës për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit, se cili do të jetë ky organ përgjegjës që i ka të dyja këto bashkë. Mendoj se duhet diçka më specifike për të kuptuar se cili i merr përgjegjësitë në këtë rast.

Petrit Vasili – Në këtë projektligj, që vjen këtu qartësisht, ka mjaft elemente dhe momente që janë shumë të rëndësishme dhe që përbëjnë pjesën e zakonshme të punës dhe të rutinës. Po marr vetëm Inspektoratin e Njërive Vendore, ku thotë: “kërkoj zbatimin e objektivit

në terren sipas lejes së ndërtimit, të kontrollojnë dosjen, dokumentacionin, të kryejnë një ose më shumë kontrolle, të njëjtin objekt sipas problematikave teknike, ligjore të objektit që ndërtohet. Më tutje shkohet dhe te mundësia e objekteve të paligjshme. Në qoftë se mbetemi dhe bëhemi robër të kompleksit të paligjshmërisë ne nuk do të bëjmë ndonjë hap përpara.

Çdo ligj kur thotë “kontrollon”, kontrollon veprimtarinë rutinë dhe atë që shkon përtej kufijve të ligjit, por ne që në titull ligjërojmë paligjshmërinë dhe ky është problemi që kemi. Pra, jemi ne që e bëjmë paligjshmërinë fakt të kryer dhe kështu nuk ecim përpara, sepse e ardhmja dhe thelbi i këtij ligji është të kontrollojë standardet e ndërtimit, mënyrën si do të jepet leja e shfrytëzimit dhe mjaft elemente të tjera, që nuk kanë lidhje me paligjshmërinë. Pra, duke vënë termin “kontroll”, tregojmë preokupacionin dhe merakun për të pasur një kontroll dhe një fokus më të madh ndaj eventualitetit të paligjshmërisë.

Ndaj unë them se është një përmirësim zhvillues dhe na çliron nga kompleksi i paligjshmërisë, që tregon edhe fuqinë tonë që ta kontrollojmë nëpërmjet një instrumenti të kontrollit që ka ligji. Vetë citimet që janë në ligj tregojnë se mjaft pjesë të fushës së veprimit të ligjit nuk kanë të bëjnë vetëm me kontrollin e paligjshëm apo me prishjen e ndërtimeve të paligjshme.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit!

Zoti Manja, urdhëroni!

Ulsi Manja - Në nenin 1 ne kemi propozuar që termi “i kundërligjshëm” të zëvendësohet me termin “i paligjshëm”. Në arsyetimin tonë i jemi referuar termit që përdor Kodi Penal dhe ligji i ri “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, sepse në nenin 51 të këtij ligji, ku flitet për inspektimin, thuhet: “Përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme”. Pra, përderisa ligji që diskutojmë sot është komplementar me ligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, por edhe termi i përdorur në Kodin Penal, ne kemi sugjeruar të përdoret ky term. Natyrisht, jemi shumë dakord që termi “i kundërligjshëm” është term më i gjerë se ai “i paligjshëm”, por, përderisa, këto ligje kanë lidhje me njëri- tjetrin, kemi sugjeruar të përdoret termi “i paligjshëm”, gjë e cila nuk e ndryshon thelbin e nenit 1.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Argumentet që solli zonja Felaj qëndrojnë, por a mund ta zgjidhim këtë shqetësim duke shtuar një përkufizim se çfarë do të quhet ndërtim i paligjshëm, ku të futen të gjitha shqetësimet që ngriti ministrja? Sepse ajo çfarë u tha në fjalën e saj ka sens, por duke dhënë një përkufizim se çfarë do të quhet, do të ishte më mirë.

Lidhur me titullin unë kam një pyetje në vazhdim të shqetësimit që ngriti zoti Vasili. Inspektorati ka vetëm për detyrë të bllokojë ndërtimet e paligjshme apo ka edhe kompetenca të tjera të kontrollit në territor?

A ka ndonjë institucion tjetër përveç tij, që merret me inspektimet dhe mbrojtjen e territorit, me inspektimet e ndërtimeve? Në qoftë se ne e heqim këtë shtesën “nga ndërtimet e kundërligjshme” dhe lëmë titullin, siç propozohet “për inspektimet e ndërtimit”, me kë institucion tjetër përplasen kompetencat?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Enkelejd Lamaj– Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me pyetjen e zonjës Hysi do të thosha se nuk ka inspektorat tjetër që të ketë përplasje kompetencash, flasim gjithmonë, jo inspektorat vendor kombëtar, por inspektorat kontrolli. Në momentin që bëhet kontrolli i një objekti, i një ndërtimi, apo i një punimi, nuk nisemi nga ideja që është i kundërligjshëm. Në fillim do ta inspektojmë dhe më pas arrihet në konkluzionin nëse është ose jo i kundërligjshëm.

Kështu që objekt i kontrollit janë të gjitha punimet dhe ndërtimet, që kryhen në territor, në bazë të një leje ndërtimi, apo të një leje zhvillimi. Në fund arrihet në konkluzionin nëse ka kundërligjshmëri, domethënë, nëse ka dalë nga leja e ndërtimit, a është në zbatim të lejes. Prandaj dhe termi...

(Diskutime pa mikrofon.)

Kjo është. Ligji për inspektimin dhe ndryshimet që vijnë tani...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, flisni me mikrofon që të dëgjohet!

Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili – Kur bën një kontroll, detyra e parë është përmbushja e standardeve. Është kontroll rutinë dhe thua i përmbush standardet, s’ka paligjshmëri, por detyrën që ta kontrollojë dhe ta certifikojë e ka ky inspektorat. Pra, është veprimtari e ligjshme, është korrekte, por ka edhe raste kur është e paligjshme. Ky është edhe një eventualitet, por ne eventualitetin, pra, paligjshmërinë, e kthejmë në ligj, në normë, në koncept dhe ligjshmërinë e kthejmë në një koncept minoritar. Nuk shkon! Nuk është vetëm ky inspektorati i këtij

vendi. Vendi ynë ka disa inspektorate. Të gjithë mund të përballemi me paligjshmërinë dhe duke qenë i vetmi, të gjitha standardet e ndërtimit i kontrollon vetëm ky. Ai nuk ka vetëm standardet e ndërtimit, ka edhe elemente të tjera të territorit. Territori nuk është vetëm ndërtim. Shikojeni, ligjin në mënyrë integrale!

Unë jam i detyruar ta lexoj, sepse e sollët ju këtë ndryshim, por ky koncept mbyllës te paligjshmëria, është një koncept i gabuar. Veprimtaria normale e tij është kontrolli i standardeve. Kështu që nuk është se vajti kontrolli dhe u gjend paligjshmëria. Absolutisht, jo! Verifikohet dhe certifikohet përmbushja, dhe mund të marrë lejen e shfrytëzimit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Enkelejd Lamaj – Në vijim do të thosha se ky është një ligj, që përcakton mënyrën e krijimit dhe të organizmit të inspektorateve dhe shtrihet në shumë ligje të tjera, si: ligji “Për produktet e ndërtimit”, ligji “Për burimet e integruara ujore”, ligji “Për kontrollin e disiplinimit të punimeve”. Pra, të gjitha këto ligje janë në funksion të këtij ligji organik, që është për funksionimin e inspektorateve. Edhe shqetësimi i zotit Vasili për këtë është.

Aktualisht, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, që do të ndryshojë, por edhe vendorët, bëjnë kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë të standardeve, të mënyrës se si zhvillohet një leje ndërtimi në momentin që jepet nga autoriteti i planifikimit. Pra, kryesisht janë inspektoratet vendore që ndjekin zbatimin në terren.

Gjatë ushtrimit të funksioneve të veprimtarisë së tyre dalin të gjitha këto, por nuk janë inspektoratet që certifikojnë një objekt. Për çdo shkelje ka masa, që parashikohen në ligje të veçanta, kur është kundërvajtje administrative, kur është penale dhe gjithmonë ligji është i lidhur me ligjet e tjera. Ky është funksioni, por në fokus është ndërtimi. Të gjitha këto janë në funksion të një ndërtimi, që nesër të jetë i ligjshëm.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Zonja Ministre, urdhëroni!

Ermonela Felaj – Në fakt, ne jemi në Komisionin e Ligjeve për të parë më shumë përputhjen ligjore dhe kushtetuese të këtyre ndryshimeve, sesa për të parë anën teknike, sepse do të jetë komision tjetër përgjegjës.

Në qoftë se ne themi “për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit pyetja që lind është : Nga se? Nga çfarë? Cili është kundërinori i kësaj shprehje?”

(Petril Vasili flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Ermonela Felaj – Ju lutem, ta përfundoj argumentin deri në fund, sepse ju dëgjova dhe nuk ju ndërpreva!

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili, ju lutem! Të përfundojë...

(Petrin Vasili flet pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – Unë nuk e kam as me termin “kontroll”, as me termin “mbrojtje”, por shprehjes i hoqët kundrinorin dhe duke i hequr kundrinorin, nuk e di nga se e mbron territorin, sepse territorin mund ta mbrosh nga shumë gjëra. Mund ta mbrosh edhe nga ndotja, mund ta mbrosh... Nuk mund të jetë kështu... Për çfarë do ta kontrollosh?

Fatmir Xhafaj – Ju lutem! Mbase, por ka shumë gjëra në territor që mund të jenë paligjshme ose të ligjshme dhe t’i ke nevojë t’i kontrollosh se si shkon ndërthurja e tyre. Nga ana tjetër, unë nuk di një ligj të ngjashëm kudo, nuk ka emrin Inspektoriat, por quhet Policia e Ndërtimit, pra është e lidhur me ndërtimin, nuk mund t’ia heqësh ndërtimin kësaj historie. Pra, do të isha më shumë për propozimin e komisionit dhe ejani ta diskutojmë, do të lëmë fjalën “të kundërligjshme” apo do të lëmë fjalën “të paligjshme”. Unë ju thashë, që në bindjen time, në mendimin tim, por edhe të grupit të punës kundërligjshmëria është më e gjerë se paligjshmëria, por jo të heqim edhe fjalën “ndërtim” tani dhe të mos identifikojmë se çfarë lloj inspektorati është ky. Në fund të fundit, ky është një inspektorat që duhet të dallohet nga çfarëdo lloj inspektorati tjetër dhe ju kujtoj që janë gati 18 inspektoriate në këtë vend. Natyrisht që do t’i përshtatemi edhe funksionit, pra do të reflektojmë në emër të tij.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Më falni, ju kërkoj ndjesë të gjithëve. Ju lutem më lini edhe mua ta menaxhoj mbledhjen, sepse atë e menaxhoj unë dhe kjo është detyra ime, me radhë. Unë kam durim dhe nuk e kam bërë ndonjëherë që t’i them ndonjërit që s’ke të drejtën e fjalës, sepse nuk kam të drejtë ta bëj këtë gjë.

Ka diçka që të kuptohemi. Ne diskutuam, edhe kur e bëmë debatin në parim, zonja Ministre, që përveç funksionit të paligjshmërisë në ndërtim, ky inspektoriat, e thatë edhe ju, e konfirmuat në vazhdim edhe të logjikës që ka pasur, do të jetë edhe për të parë cilësinë në ndërtim dhe në funksion me detyrat që ka. A mund të kemi një gjë tjetër, që të kemi mundësi që ta japim këtë kuotë, ngelet ajo që thoni ju, dakord të jepet. Por çfarë inspekton ky, cila është fusha e tij? Ky nuk është për mjedisin, nuk është për pyjet, duhet përcaktuar, jam dakord. Po të jetë ndonjë gjë që të kemi mundësi që ta fokusojmë më mirë me objektin, sepse ajo që unë bie dakord me kolegun Vasili dhe me zonjën Hysi është te fakti që ka nevojë të fokusohet te vetë objekti dhe titulli i ligjit, pra mund të ishte një zgjidhje e plotë.

Zoti Subashi, ka një sugjerim.

Armando Subashi – Në fakt, duke dëgjuar kolegët, do të tentoj të jap një variant që besoj se do t'i kënaqë të gjithë me idenë për t'i pasqyruar të gjitha meraket që kemi dhe mund ta bëjmë për inspektimin e ndërtimit, duke e mbajtur këtë, sepse kjo është e rëndësishme, duhet cilësuar kjo gjë, pra “Për inspektimin e ndërtimit, kontrollin dhe mbrojtjen e territorit” dhe këtu mbyllet titulli i ligjit. Pra kemi brenda edhe inspektimin e ndërtimit, kemi edhe kontrollin e territorit, kemi edhe mbrojtjen e tij. Besoj se kjo e zgjidh dhe nuk lë asnjë shteg për dyshime ,as për të thënë nga kush, nga se, si, qysh, tek, sepse çdo gjë është e qartë me këtë lloj.

Fatmir Xhafaj – Ta marrim me qetësi. Besoj, zonja Ministre, që kjo nuk ju pengon. Ky është një propozim.

Armando Subashi – Edhe inspektimin e ndërtimit e mban...

Ermonela Felaj – Nuk dua që të dukem sikur kam ardhur për të thënë “jo” për çdo gjë, nuk është ideja këtu. Pjesa e dytë ku flitet për kontrollin dhe mbrojtjen e territorit të jep idenë e diçkaje ushtarake, sikur hynë në lojë edhe Ministria e Mbrojtjes “Kontrolli dhe mbrojtja e territorit”.

Fatmir Xhafaj – Më falni, po ju “mbrojtjen e territorit”, e keni në këtë që keni sjellë.

Ermonela Felaj – Në fund të fundit, edhe kur respekton normat, standardet e vendosura për të kryer ndërtime, finalja, qëllimi është që t'i të mbrosh territorin nga ndërtimet e kundërligjshme. Nga ndërtimet nuk ka kuptim ta mbrosh, sepse natyrisht ndërtime do të ketë.

Fatmir Xhafaj – Më falni, Inspektoriatin për Mbrojtjen e Mjedisit si e bëni ju?

Ermonela Felaj – Më mirë ta lëmë siç ishte se sa “shto ujë, shto miell”. Më mirë e lemë ashtu siç ishte në qoftë se mbërrijmë në këtë diskutim dhe nëse unë mundem ta bëj këtë propozim.

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi, për inspektimin e ndërtimit biem dakord. Dakord, të rri ashtu siç ishte.

Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 2 “Qëllimi”. A ka ndonjë diskutim.

Ermonela Felaj – Me këtë ndryshim që bëmë, unë besoj se do të duhet të biem dakord me këtë formulim, megjithëse më lejoni ta them se bëmë debat gjatë prezantimit në parim për nenin 1, e njëjta gjë është thënë po ta shikosh me vëmendje nga ana gjuhësore.

Inspektoriati do të vijojë të respektojë normat, standardet, kushtet zhvillimore, legjislacionin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit dhe të burimeve ujore dhe natyrisht qëllimi i të gjitha këtyre, që edhe kur bën këto gjëra Inspektorati qoftë ai qendror, qoftë ai vendor në finale e ka mbrojtur territorin. Pra, kemi thënë të njëjtën gjë, por duke u shprehur ndryshe.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord me ndryshimin e bërë?

Neni 2. Dakord.

Faleminderit!

Neni 3 “Përzgjedhja dhe mandati”, ndryshimi që i bëhet nenit.

Dakord siç është?

Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja - Këtu thuhet se “Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit në njësinë qendrore dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit. Në pikën 2 thuhet: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit përputhet me....”

Fatmir Xhafaj – Projekti i ardhur nga qeveria.

Ulsi Manja - Këtu ka pasur një diskutim nëse duhet të ekzistojë apo jo Inspektoriati në nivel të lartë. Ne sugjerojmë që kjo t’i përcillet si rekomandim Komisionit të Veprimtarive Prodhuese që është edhe komision përgjegjës, që ta diskutojë më teknikisht.

Fatmir Xhafaj – Të dëgjojmë zotin Vasili.

Petrit Vasili – Kjo nuk është çështje për Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, nuk bie 100 % dakord. Jam plotësisht dakord me shqetësimin e zotit Manja që ka problem, por problemi më i madh është se më pas ajo që lidhet me këtë çështje është përcaktuar që këto kompetenca do të zgjidhen me dakordësi dhe njësia vendore do t’i delegojë kompetenca qarkut. Përcaktime të tilla më vjen keq, janë më pak se qesharake. Automatikisht unë jam dakord me këtë vizion siç është përcaktuar, këtë vizion e ka rrëzuar Inspektoriati i Qarkut, sipas dëshirës së propozuesve, kurse palët vijnë dhe bien dakord që unë do të të jap ndonjë kompetencë ty ose edhe nuk ta jap këtë kompetencë, kjo nuk është në nivel ligji, por qesharake. Kompetencat o janë këtu, o janë edhe këtu. Nuk është Inspektoriati i njësisë vendore që i bën dhuratë qarkut apo nuk i bën. Ç’do të bëhet? Do të bëhet marrëveshje me çdo qark, çdo njësi vendore do të bëjë marrëveshjen e saj. Për mua, organizimi në dy nivele është shumë mirë dhe solid, i përgjigjet organizimit të territorit. Inspektoriati qendror hyn për ato çështja që janë të nivelit kombëtar dhe çështja mbyllet këtu. Ne duhet të kemi kurajë të

marrim këtë vendim dhe ta bëjmë këtë propozim, se nga ana ligjore ky propozim do të ishte një propozim solid.

Fatmir Xhafaj – Zoti Manja!

Ulsi Manja – Ky formulim ka ardhur për shkak sepse në Kushtetutë ruhet qarku si njësi e qeverisjes vendore, kam përshtypjen unë, sepse thuhet: janë bashkitë, qarqet. Pra, kjo ka qenë linja, besoj, por unë personalisht mendoj se organizimi i inspektoratit në nivel qarku duhet riparë, sepse edhe në nenin 7, ku flitet për kompetencat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit në nivel qarku, nuk thuhet e çfarë kompetencash do të ketë ky inspektorat.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk thuhet çfarë kompetencash do të kryeje, por flitet vetëm për mënyrën e organizimit.

Fatmir Xhafaj – Po, më falni! Do të dëgjojmë...

Ermonela Felaj – Krijohet keqkuptim më kot, dhe dashur pa dashur bëjmë edhe disa konsiderata për njëri-tjetrin, që nuk qëndrojnë, sepse ne kemi ardhur shumë seriozisht në këtë komision dhe kemi parë çdo lloj ligji që flet për aspektet e ndërtimit. Tani, më duhet t'ju sqaroj se inspektorati i qarkut nuk është një shpikje e jona, sepse e ka ligji aktual – tetë vjet që e ka gati –, por nuk ka përbërë ndonjëherë problem kjo pjesë.

E dyta, po ta shohësh ligjin aktual pse është ky inspektorati i qarkut, ky nuk është në çdo qark. Ky është aty ku bashkitë nuk kanë kapacitete njerëzore. Pra, unë po flas për ligjin aktual, se ne nuk kemi ndërhyrë fare në këtë pikë, as për ta ribërë, as për ta hequr ose ndonjë diskutim tjetër. Aty ku njësitë vendore nuk kanë kapacitete njerëzore për të formuar, për të ngritur inspektorate, këto lloj kompetencash ia delegojnë qarkut me marrëveshje. Kjo është ajo që thotë ligji.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, falni, se ka edhe një respekt reciprok. Unë ju dëgjoj, ju nuk më dëgjoni. Në ndarjen territoriale nuk është diskutuar për qarkun.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili, do t'ju lutesha për një gjë. Debat është ky, por është një debat me radhë. Ju folët, zoti Manja foli. Tani, zonja ministre ka të drejtën e fjalës.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Kryetar! Ne nuk kemi ndërhyrë në këtë pikë. Thjesht kemi ndryshuar emërtimin, meqenëse e kishim ndryshuar në fillim. Vetëm për këtë gjë është

ndërhyrë, jo për të prishur thelbin apo kuptimin. Në qoftë se ju doni ta hiqni sekretariatën e qarkut, hiqeni dhe s'e kemi fare problem këtë pjesë, se nuk kemi ardhur për këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Dashamir Peza – Unë bie dakord me atë që thotë zoti Vasili, por këtu ka një lloj keqkuptimi, domethënë, duke u mbështetur te ligji ekzistues. Ligji ekzistues ka marrë parasysh faktin se në ndarjen e vjetër territoriale kishte shumë njësi vendore të cilat nuk kishin kapacitetet e nevojshme për ta realizuar këtë detyrë, i është ngarkuar qarkut detyra për të kryer këtë funksion.

Fatmir Xhafaj – Ka tetë vjet që kështu bëhet.

Dashamir Peza – Tani që ne kemi bërë ndarjen administrative dhe jemi të vetëdijshëm për ndarjen e re administrative, unë gjykoj se me ndarjen e re administrative nuk do të jetë më e nevojshme që këtë funksion ta kryejë qarku, sepse ndarja e re administrative siguron, besoj unë, potencialisht, kapacitetet e nevojshme për ta realizuar nga bashkia e vet një veprimtari të tillë. Do të ishte mirë të gjenin një mirëkuptim midis qeverisë dhe neve që jemi këtu. Unë mendoj se vetë reforma territoriale e ka bërë të panevojshme që qarku të ushtrojë këto funksione. Unë mendoj se ndoshta tani është momenti që në këtë situatë të re ta ndryshojmë këtë gjë, pa prishur, por gjithmonë me mirëkuptim.

Fatmir Xhafaj – Kam vetëm një gjë; do t'u lutesha kolegëve që...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem! Çfarë keni? Me radhë.

Unë po bëj vetëm një parantezë, nuk po shprehem. Pastaj, le të shprehet secili. Unë kam këtë gjë: të jemi të kujdesshëm, që të mos bëjmë ndërhyrje që mund të krijojnë efekte të tjera, sepse këto janë mendime, nuk është një ligj i plotë, që ne ta shikojmë në tërësinë e tij. Duke qenë mendime, rrezikon që në ligjin bazë të krijojë implikacione. Në qoftë se nuk krijon është çështje tjetër. unë vetë nuk e ndaj këtë. Prandaj po ju them, po ju ftoj juve, është një ftesë miqësore.

Zoti Klosi. Pastaj zoti Subashi.

Blendi Klosi – Unë mendoj, zoti Xhafaj, zoti kryetar, se ne nuk duhet të hyjmë te debati i qarqeve, sepse është e vërtetë që ka inspektorate të qarqeve – zoti Peza, edhe për ju e kam debatin –, pra ka inspektorate të qarqeve, inspektorate këto, të cilat nuk janë drejtpërdrejt në varësi të pushtetit vendor. Pra, forcimi i kapaciteteve të pushtetit vendor, me ndarjen e re territoriale, krijimi i 61 njësive më të mëdha, të cilat do të kenë kompetenca më të mëdha dhe do të kenë mundësi të krijojnë edhe njësitë e tyre të qenësishme, nuk do të thotë se i nxjerr

jashtë loje inspektoratet aktuale të qaqeve, të cilat janë në varësi të Inspektoratit Qendror. Pra, ne duhet të ndajmë një parim. Për sa kohë nuk e ndryshojmë parimin që, kemi edhe nivel qendror inspektorati, edhe nivel lokal, pra dy nivele, nivelet e qarqeve nuk hyjnë në këtë histori, sepse janë pjesë e nivelit qendror dhe bëhen për llogari të inspektoratit qendror të ndërtimit, që ne po e rregullojmë për ta forcuar në lidhje me zbatueshmërinë e ligjit. Nuk po e ndryshojmë konceptin, pra të eliminojmë një nga nivelet, ose qendrore ose lokale. Nuk kemi pse të merremi me qarqet, sepse, ndonëse emërtohen “të qarqeve”, nuk janë në varësi të pushtetit vendor, por në varësi të inspektoratit qendror. Prandaj, unë nuk mendoj se duhet të hyjmë në komente për këtë ndryshim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, me radhë.

Zoti Klosi, mbaruat, ju lutem?

Fjalën e ka zoti Subashi. Pastaj zonja Hysi, për një pyetje, më pas zoti Vasili. Po, edhe zoti Fino.

Armando Subashi – Tashti, që në vijim të arsyetimit që bëri zoti Klosi, unë mendoj se duhet të bëjmë një dallim të qartë në gjithë këtë histori. Ligji njih, po themi, dy nivele inspektoratesh: njih inspektoratin qendror, njih edhe inspektoratin e njësisë së qeverisjes vendore. Mënyra si organizohet inspektorati qendror, mund të jetë ashtu siç po themi, që ka një drejtori në qendër, ka edhe degët e veta, të cilat mund t’i ketë në çdo qark, në çdo rreth e të tjera e të tjera. Kjo është pjesë e organizimit të inspektoratit qendror. Ky është niveli i parë.

Niveli i dytë është inspektorati i njësisë së qeverisjes vendore. Aty parashikohet që një njësi nuk e bën dot vetë punën dhe mund t’ia delegojë qarkut. Ky nuk është detyrim. Kjo është një e drejtë, ose një dritare e hapur që i është lënë. Nëse nesër, të 61 bashkitë janë në gjendje ta bëjnë këtë punë, e bëjnë vetë. Nuk ia delegon askush qarkut dhe, de facto, kjo që ne kemi merak sot ngelet pa veprim. Por mund të ketë një bashki, një mund të ketë, Memaliaj, po ia fus kot, që nuk e bën dot vetë. Çfarë do të bëjë? Atëherë ia delegon qarkut. Tani, pse do ta mbyllim këtë dritare sot? Çfarë qëllimi kemi? Flas gjithmonë për nivelin e inspektoratit të qeverisjes vendore, ndërsa qendrori është i zgjidhur, e organizon vetë punën e vet. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi. Kishit pyetje?

Pastaj zoti Vasili e pastaj zoti Fino.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje, sepse neni 4 i projektligjit duhet parë në raport me nenet 5, 6, 7. Në fakt, thuhet se ngrihen dy inspektorate: një në nivel kombëtar, dhe inspektorati i mbrojtjes së territorit në njësinë vendore përkatëse.

Në pikën 2 të nenit 4 thuhet se inspektorati i mbrojtjes së territorit ngrihet në nivel qarku. Në fakt, unë në vazhdim të diskutimit që bëri kolegu Subashi, nuk shoh asgjë të keqe që në momente të caktuara të ketë një inspektorat të mbrojtjes së territorit në nivel qarku, por duhet të rregullojmë formulimin te neni 4 i projektligjit, sepse del sikur janë të njëjtët inspektorate, kur në të vërtetë janë të ndryshëm. Nuk kanë të njëjtin rankim. Pra, i pari që renditet është inspektorati kombëtar, i dyti ai vendor. E nisim nga poshtë: i pari, nga baza, është vendori, i dyti është qarku dhe kombëtari. Ndërkohë që ju thoni në pikën 1: kontrolli i territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve, në territor kryhet nga ky, ju mund të thoni: në rastet kështu e kështu, ngrihet Inspektorati. Kompetencat përcaktohen në pikat 6,7 dhe 8. E kupton? Për pikën 2. Mënyra sesi është formuluar neni 3 del që ke tri inspektorate detyrimsht. Në fakt, nuk janë tre, por dy. Jam dakord me propozimin tuaj që në nivel qarku duhet të ketë një marrëveshje. Për shembull, një njësi e vogël mund të ketë probleme sidomos në momentet e para që po zbatojmë ligjin. Mund ta riformulojmë më qartë?

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Të mos i humbasim thelbin dhe seriozitetin gjësë, të rrekemi këtu dhe të ligjërojmë struktura fakultative, pasi nuk kam dëgjuar ndonjëherë në dhjetëra ligje që kam parë, struktura fakultative që edhe janë, edhe nuk janë. Po i lindi në zemër t'i japë ndonjë gjë, e japin; po nuk i lindi, nuk e japin. Strukturat dhe piramidat e kontrollit shtetëror janë shumë të qarta: cilat janë institucionet, si funksionojnë dhe çfarë kompetencash kanë? Kjo pikë është e rrëzuar që në nenin 6, ku thuhet se këto situata zgjidhen në marrëveshje mes palëve. Çfarë është kjo? Me marrëveshje mes palëve zgjidhen kompetencat e inspektorateve? Këtu është çështje e vendimmarrjes. Ose e kemi me dy nivele dhe qëndrojmë aty, ose nëse është me tre nivele, është edhe ky tjetri, ka edhe këto kompetenca që nuk i ka njësinë vendore përkatëse.

Në këtë, pikë t'u largohemi këtyre gjërave fakultative dhe të mos gjejmë truke për të sajuar, por të marrim një vendim të qartë dhe kurajoz, ose e kemi me 2 nivele dhe qëndrojmë këtu.

Ndarja e re territoriale i krijoi një optikë të re çështjes. Nuk kemi pse të hezitojmë, sepse reflekton një situatë të re që ka ndodhur edhe në territorin e organizimit dhe çështja mbyllet këtu. Nëse e keni me merak të madh, atëherë ka këtë kompetencë të vetme dhe

ekziston në këtë mënyrë. Në nenin përkatës, ai është një inspektorat që do të krijohet, por ligji nuk ka përcaktuar të ketë as kryeinspektorë. Pra, unë them, hajdeni të marrim vendim dhe të mos ndihmojmë strukturat fakultative!

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Ky është një diskutim shumë interesant. Po e marr nga parafolësi i fundit. Ne kemi bërë një reformë, e cila do të jetë funksionale kur të vijë ligji i ri nr. 8652. Në këtë ligj do të ketë elemente edhe të kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në territor. Ministri e tha shumë drejt se e kanë marrë projektin siç ka qenë dhe është lënë fakultative. E thotë neni 7 sipas një marrëveshjeje të lidhur midis palëve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pra, kur një bashki nuk e kryen dot mundësinë e kontrollit të territorit, mund t'ia delegojë këtë pushtet qarkut. Kështu ka qenë. Këtë nen e ka lënë dhe e ka cilësuar.

Zoti kryetar, po të shikosh praktikën e sotme, asnjë bashki sot, 384 që kemi në këto momente deri më 21 qershor, nuk i ka dhënë kompetencë qarkut. Në vetëdijen time nuk ka asnjë marrëveshje. Asnjë bashki aktuale deri më sot nuk i ka dhënë kompetencë qarkut. Ky nen ka mbetur evaziv.

Zoti Vasili bëri një diskutim si zakonisht racional. Ne bëmë një reformë dhe nuk mund të themi që 61 bashkitë, nesër pas 21 qershorit nuk do të kenë kapacitetet. Kur 384 njësi vendore sot nuk ia dhanë asnjëherë mundësinë qarkut të kontrollonte, të kishte Policinë Ndërtimore në nivel qarku, se bashkia nuk e bënte dot këtë gjë, po nesër që janë një e treta dhe kapacitetet do të jenë shumë herë më të larta, nuk diskutohet që do të jenë edhe më të forta. Mendoj që neni 3 duhet të mbetet vetëm me një pikë. Ky është propozimi im, ku kontrolli i territorit, zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit kryhen nga Inspektorati i Mbrojtjes në territor të njësisë vendore përkatëse dhe Inspektorati Kombëtar. Nuk kemi pse të futemi në elemente të tjera, sepse praktika na ka treguar se nuk është bërë asnjë lloj marrëveshjeje deri më sot. Pse duhet ta lëmë kot? Kur ne kemi bërë një reformë dhe themi se i kemi rritur kapacitetet e 61 bashkive dhe do të kemi një ligj të ri, atë me nr. 8652. Kur të vijë ai ligj i ri, do të flasim përsëri dhe do të diskutojmë edhe për këtë situatë. Unë them ta lëmë në këtë nivel dhe të mos krijojmë kot një artificialitet.

Më lejoni të them edhe një gjë tjetër, në cilësinë e relatorit që kam qenë për buxhetin, çfarë bëmë ne në buxhetin e vitit 2015? Ne bëmë një ulje drastike të shpenzimeve të qarqeve. Bëmë shumë mirë. Sot qarqet do të kenë shumë pak fonde në kuptimin e shpenzimeve, të shërbimeve operative, sepse do t'i bëjë bashkia. Kjo do të thotë se nuk do ta

kenë dot as këtë lloj mundësie për ta kryer me 10-15 vetë që kemi në çdo qark për të bërë këtë gjë edhe sikur t'ia delegojë, sepse sipas këtij ligji, nëse bashkia nuk e bën dot dhe i thotë qarkut ta bëjë, ky i fundit me çfarë do ta bëjë? Këtu është problemi. Me çfarë fuqie njerëzore, me çfarë fondesh, me çfarë mjetesh do ta bëjë? Me kushtet e buxhetit të vitit 2015 që ne kaluam. Të gjitha argumentet që thashë, që i përmblodha dhe në përgjithësi të gjithë kolegët janë dakord, unë mendoj të mbetet vetëm pika e parë e nenit 3. Në nenet 6 dhe 7 duhet të hiqet pika në të cilën thuhet: “Kur ka marrëveshje....” e të tjera.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Klosi.

Blendi Klosi - Faleminderit, zoti kryetar!

Po i ndjek me shumë vëmendje diskutimet e djeshme dhe të sotme për këtë projektligj, por mendoj që jemi pak jashtë kohe. Prandaj do të kundërshtoja pak kolegun Fino për propozimin e bërë, se ne nuk mund të bëjmë tani ndryshimin e këtij neni apo të strukturës aktuale të Inspektoratit të Ndërtimit, por pasi ne të kemi një ligj kuadër të plotë, që zoti Fino e përmendi me shumë të drejtë “Për decentralizimin”, ku do të shikojmë më së miri kompetencat që do të marrë Inspektorati i Ndërtimit Lokal. Ne mund të bëjmë ndryshim të strukturës aktuale të Inspektoratit të Ndërtimit. Mendoj të mos hyjmë në ndryshimin e strukturës së re, kur nuk kemi zgjidhur në një debat 15-vjeçar kompetencat e Inspektoratit të Ndërtimit. Unë mbaj mend një diskutim shumë të fortë që është bërë që në vitet 2000-2001 kur u ndërtua kjo strukturë, se cilat do të jenë kompetencat e pushtetit vendor dhe atij lokal.

Për pikën e parë jam kundër që të ndryshojmë strukturën aktuale. Ta lëmë siç është, duke pritur një ndryshim që do të ndodhë pas një debati që do të bëjmë së bashku me reformën decentralizuese tashmë, pasi bëmë atë territoriale.

Ne jemi edhe pak gabim në kohë, sepse po u mësyjmë kaq shumë ndërtimeve pa leje, ndërkohë që unë shpreh bindjen se Shqipëria po bëhet, këtu doja të tërhiqja vëmendjen e kolegëve deputetë në këtë komision, se ne nuk kemi situatën që ka qenë deri para se të fillonte procesi për ruajtjen e territorit. Në Shqipëri do të jetë shumë e vështirë që dikush të mendojë të bëjë ndërtim pa leje që nga muajt e fundit e në vazhdim. Ne duhet të krijojmë një filozofi tjetër edhe për këtë inspektorat, i cili nuk do të jetë më për ndërtimet pa leje, të cilat ne duhet t'i bllokojmë. Ndërtimi pa leje është një gjë që duhet të dalë jashtë konceptit të zhvillimit të këtij vendi. Prandaj mendoj se për të dyja këto koncepte ne jemi pak jashtë kohe për të parën, jemi përpara në kohë, ndërsa për të dytën, jemi pak vonë. Mendoj se më shumë sesa me ndërtimin pa leje, që do të jetë një gjë jashtë logjikës së zhvillimit të

Shqipërisë, duhet të merremi me cilësinë e ndërtimit apo zbatimin e kriterëve. Ta mendojmë si kapitull të mbyllur idenë se Shqipëria nuk do të bëhet.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Klosi!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, jo pse m'u referua zoti Klosi, po unë ju solla shembuj konkretë të veprimtarisë së pushtetit vendor, që nga viti 1992, madje që kur ka dalë ligji “Për Policinë Ndërtimore”. Thashë që nuk ka asnjë marrëveshje, deri në këto momente, nga asnjë bashki, që t'ia ketë dhënë me qejf të madh qarkut. A do ta lëmë këtë nen në këtë situatë? Ky quhet nen parazit. Këtë thashë.

Unë thashë që inspektorati ngrihet në nivel vendor dhe qendror. Kur dhashë argumentet e tjera, se si do të vijë ligji i ri etj., natyrisht që jemi këtu për të diskutuar dhe për të bërë më të mirën e mundshme në ligjin e ri të pushtetit vendor. Nuk ia heqim këtë të drejtë as pushtetit qendror, as atij vendor. Me këtë logjikë që tha zoti Klosi – jam kundër tij – i bie që të pyesim se çfarë po bëjmë ne sot. Ministri, i cili ka dy ditë që vjen këtu, na tha që është ngritur një grup pune, me urdhër të Kryeministrit, që Inspektorati i Ndërtimit të kalojë në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Mund të mos na vinte projektligji. Merrte vendim qeveria, e kalonte te ministria përkatëse, kalonte struktura nga njëra ministri te tjetra – është e drejtë e organizimit të qeverisë – dhe ministri që merrte këtë detyrë, bashkë me strukturën, mund të vinte e të na thoshte: “Kam këto probleme dhe dua të bëj këto amendamente në projektligj”. Ndërkohë që grupi i punës dhe ministrja e Shtetit për Parlamentin, kanë bërë përpara: është marrë në konsideratë kalimi në strukturën e rendit, por njëkohësisht i është dhënë mundësia, me urdhrin e Kryeministrit, që të sjellë amendamentet e nevojshme në funksion të perfeksionimit të ligjit.

Është pak kontradiktore, zoti Klosi, sepse i bie që unë të them: “Të shkojë një herë të Ministria e Rendit, pastaj të na vijnë amendamentet”. Për mua, ky është nen parazit. Po të doni, e lëmë, por nuk do të zbatohet, siç nuk është zbatuar deri tani.

Ky është i gjithë diskutimi.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se u shfaqën të dyja pikëpamjet. Njëra që sugjeron të mbetet kështu siç është dhe tjetra që sugjeron që nuk ka arsye të rrijë në ligj. Të dyja argumentet bëjnë sens në logjikën e tyre, por unë mendoj se duhet të mbajmë parasysh natyrën e këtij projekti.

Së pari, ky nuk është një projekt i ri, për ta parë në harmoni, por një projekt ndryshues. Këta kanë ardhur që të ndryshojnë disa elemente të situatës aktuale, për ta bërë strukturën me eficiente.

E dyta, që është shumë e rëndësishme, nuk jemi komision përgjegjës, por vetëm për dhënie mendimi. Do t'ia japim komisionit përgjegjës me të dyja mendimet. Nëse propozimi vlerësohet, le të zgjidhet. Dakord?

(Diskutime pa mikrofon.)

Zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Edhe ne i patëm këto diskutime. E dini se pse e kemi lënë? Menduam që reforma territoriale nuk është përmbyllur ende, pasi ende nuk e kemi parë ligjin e ri për organizimin e pushtetit vendor.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne e kemi filluar punën në shtator, ndërsa tani jemi në dhjetor. Akoma nuk e dimë nëse do ta ruajmë qarkun si strukturë apo do ta heqim. Me këtë logjikë, e lamë kështu. Është e drejtë ndërhyrja juaj, zoti Xhafaj, që këto ndryshime nuk janë të natyrës thelbësore. Do të ishte më oportune që t'ia linim atij komisioni për ta vendosur.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Më falni, a mund ta dëgjojmë ministren? Ajo përfaqëson qeverinë dhe po mbron projektin. Ta bëjmë me radhë.

Unë them që nuk është e nevojshme ta bëjmë me votim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ka një kërkesë për procedurë për ta votuar këtë gjë? Dakord.

Kush është dakord që të rrijë kështu siç e ka sjellë qeveria? Kundër?

8 me 6. Të rrijë kështu siç e ka sjellë qeveria.

Megjithatë t'i vëmë të dyja propozimet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë them t'i vëmë të dyja propozimet. Ata mund të bëjnë një analizë më të plotë. Kjo më duket më racionale.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti Vasili, më vjen keq, por unë nuk ia imponova mendimin ndokujt!

Neni 5. Dakord?

Zoti Manja.

Ulsi Manja – Në pikën 2 të nenit 5, që ndryshon nenin 4, thuhet: “Inspektorati i mbrojtjes së njësive vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësive vendore përkatëse”. Kam një propozim: struktura, numri i punonjësve dhe paga e inspektorit të mbrojtjes në nivel vendor të miratohen me vendim të këshillit bashkiak, sepse nuk është thënë se kush do ta miratojë këtë strukturë.

Fatmir Xhafaj – Zonja Ministre.

Ermonela Felaj – Nuk kemi ndryshuar gjë. Po të kemi merak për strukturën, është ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor” që ia jep këtë të drejtë, kështu që nuk ka nevojë t’i përsërisim gjërat nga ligji në ligj.

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili.

Petrit Vasili – Çështja e emërimit. Ky nen, në raport me inspektoratin qendror, ka një problem logjik. Këtu thuhet se kryeinspektori i njësive vendore emërohet nga kryetari. Kush e propozon?

Për inspektoratin qendror, propozon ministri dhe emëron Kryeministri.

Fatmir Xhafaj – Është organ kolegjal dhe e zgjidhin brenda tij.

Petrit Vasili – Cili është organ kolegjal?

Fatmir Xhafaj – Qeveria, propozim?

Po këtu kush do ta propozojë?

Petrit Vasili – Ndryshe nga qeveria, njësia vendore ka këshillin.

Fatmir Xhafaj – Këshilli nuk mund t’ia propozojë kryetarit, sepse është organ përfaqësues.

Petrit Vasili – Po duhet të gjendet mekanizmi si do të propozohet.

Fatmir Xhafaj – Është e drejta e tij, sepse është organ monokratik dhe ka të gjitha kompetencat për ta bërë këtë gjë.

Petrit Vasili – Organ monokratik, të paktën ma kurseni dhe ma thoni pa mikrofon këtë gjë!

(Zoti Xhafaj ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Qeveria ka sjellë disa ndryshime, por ne mund të bëjmë ndryshime të tjera, nuk na pengon askush.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, kemi ruajtur traditën në këtë proces.

Neni 6. Dakord.

Neni 7. Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që do ta propozojë, ajo shkon për logjikë.

Neni 8. Dakord, sepse është e njëjta logjikë.

Neni 9.

Piro Lutaj – Përveç të tjerave, objekti i këtij ligji është që ta zhvendosë Inspektoratin Ndërtimor nga një ministri tek tjetra. Në relacion del që në paragrafin e parë, ndërsa këtu del vetëm në nenin 8. Kështu që dua ta qartësojmë këtë me zonjën ministre. Pra, është paragrafi i tretë i nenit 9, i cili thotë: “Struktura dhe organika e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit përcaktohet nga Kryeministri me propozim të ministrit përgjegjës”. Cili është ministri përgjegjës? Si do ta kuptojmë në një dispozitë të ligjit? A e keni të përcaktuar, apo duhet ta nënkuptojmë?

Fatmir Xhafaj – Unë nuk di që të ketë një ministër për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve nga veprat penale. Ne mund ta themi: “Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë”, sepse ai për atë është ministër përgjegjës në të gjithë praktikën.

Zonja Felaj, keni fjalën.

Ermonela Felaj – Nuk e kemi përdorur emrin direkt për shkak të teknikës legislative.

Për sa i takon këtij lloj formulimi, po ju shpjegoj logjikën si e ndërtuam ne, sepse një formulim të pastër nuk gjen në fushën e përgjegjësisë së ndonjë ministrie, por me anë të një interpretimi del në këtë konkluzion.

Ne morëm për bazë përkufizimin që ka legjislacioni penal, i cili kujdeset për garantimin e 1, 2 dhe 3 gjërave, por edhe për mbrojtjen e territorit. Ministria që zbaton drejtpërdrejt legjislacionin penal është Ministria e Brendshme, nuk ka një ministri tjetër që e zbaton si ajo. Nisur nga kjo lloj logjike indirekte futëm shprehjen e veprave penale...

Fatmir Xhafaj – Ministria e Financave nuk e zbaton atë?

Ermonela Felaj – Më falni, ministria që e zbaton në mënyrë direkte për çdo lloj vepre penale ishte kjo ministri dhe prandaj futëm fjalët “veprat penale”. Nga ana juaj është sugjeruar që të hiqen këto fjalë. Unë dua t’ju them se edhe po i hoqëm këto fjalë nuk krijohet asnjë problem, sepse po të lexojmë fushën e përgjegjësisë së ministrit të Brendshëm do të shohim që me interpretim del kjo logjikë.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, bini edhe ju dakord me propozimin e kolegut.

Zoti Manja, keni fjalën.

Ulsi Manja – Kemi rënë dakord me përfaqësuesit e qeverisë që fjalët “veprat penale” të hiqen.

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino, keni fjalën.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, ju e mbani mend shumë mirë që unë kam qenë sistematik në diskutim kur vjen puna për strukturat dhe emërimet.

Unë e quaj të tepërt që të merret Kryeministri me strukturën dhe me emërimet. Kryeministri bën politikë, drejton. Kështu që mendoj se duhet të merret ministri i linjës, i cili bën strukturën, emëron kryeinspektorin. Kryeministri është edhe mbi ministrin, ai mund të ndërhyjë sa herë të dojë. Ministri bën strukturën dhe ia paraqet Kryeministrit, i cili mund ta firmosë dhe quhet të mirëqenë. Pra, ministri i thotë: urdhëroni këtë emër për kryeinspektor, ndërsa Kryeministri mund t’ia firmosë ose jo.

Ideja ime është që në të gjitha rastet, kur kam diskutuar edhe herë tjetër, strukturën dhe emërimet le ta bëjnë ministrat e linjës, sepse janë njerëzit që do të merren direkt me punën. Kryeministri është mbi ministrat, ndërhyr në çdo kohë dhe në moment. Ai mund ta shkarkojë edhe vetë ministrin, pa lë një kryeinspektor apo drejtor, sepse është Kryeministër në Kushtetutë.

Unë i kam diskutuar gjithmonë këta dy paragrafë, gjithsesi nuk më krijon ndonjë problem edhe po qëndruan kështu. Por do të ishte më mirë që ai ministër që e merr t’i dalë për zot punës përkatëse.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Ministre, cila ka qenë logjika e propozuesit?

Ermonela Felaj – Ne nuk kemi ndërhyrë në këtë pikë, sepse në nenin 8 të ligjit aktual thuhet: “Struktura dhe organika e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik dhe Kombëtar përcaktohet me urdhër të Kryeministrit me propozimin e ministrit përgjegjës në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës”. Ne thjesht kemi ndryshuar emërtimet, por në logjikë nuk kemi ndërhyrë.

Fatmir Xhafaj – Ju mendoni të qëndrojë kështu siç është?

Ermonela Felaj – Po.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 9, me sugjerimet dhe me ndryshimet që u bënë.

Neni 10.

Ulsi Manja – Neni 10 ndryshon nenin 8 dhe pas këtij neni shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje.

Kemi rënë dakord që germet “a” dhe “c” të bashkohen në një paragraf të vetëm.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord?

Ermonela Felaj – Ne jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 11.

A ka vërejtje nga relatori, kolegët?

Ulsi Manja – Për nenin 11 kemi propozuar të hiqen fjalët “menjëherë” dhe “pa asnjë kufizim”.

Ermonela Felaj – Në fakt, kjo përbën edhe thelbin pse kemi ardhur me këto ndryshime në ligjin për Inspektoratin e Ndërtimit. Çfarë kemi dashur të ndajmë? Kemi dashur të ndajmë një herë e mirë kompetencat e INUV-ve dhe ato të Inspektoratit Kombëtar të Ndërtimit, sepse ligji aktual, ashtu siç është ndërtuar, krijon përplasje dhe konfuzion.

Nga ana tjetër ka një logjikë në këtë mes për zonat me rëndësi kombëtare, unë nuk po i përmend të gjitha, sepse është zgjeruar rrethi i këtyre zonave, lejet e ndërtimit i jep Këshilli Kombëtar i Territorit, pra KKT-ja, që është një organ qendror, pra kryetari i bashkisë nuk jep leje ndërtimi për këto zona. Kryetari i bashkisë jep leje ndërtimi në çdo zonë tjetër që nuk është e këtij niveli dhe e rëndësisë kombëtare. Përderisa zbatimin e lejeve, që jep kryetari i bashkisë, e ndjekin INUV-et, ato janë instrumenti që ka çdo kryetar bashkie për të siguruar ecurinë sipas lejes së dhënë, kurse për KKT-në është Inspektorati Kombëtar. Prandaj ky i fundit në zonat me rëndësi kombëtare nuk duhet të kufizohet nga fakti nëse ndërhyt ose nuk ndërhyt INUV-i apo nëse e bën apo jo punën e tij INUV-i.

Përpara se të sillnim këto ndryshime, Këshilli i Ministrave e ka shprehur të njëjtin vullnet edhe në VKM-në nr. 932, të cilën e ka ndërmarrë pikërisht për t’i lejuar Inspektoratit Kombëtar që vetëm në zonat me rëndësi kombëtare të jetë ai organi ekskluziv përgjegjës dhe jo INUV-i.

Nga ana tjetër, ne të gjithë bashkë jemi dëshmitarë se çfarë ka ndodhur me lejet e dhëna në zona të kësaj rëndësie. Për shembull, dihet se çfarë bëhet me lejet në Parkun Kombëtar të Tiranës, ku është krijuar konflikti se cili inspektorat duhet të ndërhyjë. Për këtë arsye kemi bërë këtë lloj ndarjeje, që besoj se është e qartë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Manja.

Ulsi Manja – Në thelb jemi dakord me këtë shqetësim, sepse, në fakt, edhe thelbi i këtij ndryshimi është zgjidhja që kërkohet të jepet për situatën në praktikë. Nga pikëpamja e teknikës legjislative, në diskutimin që bëmë kërkojmë të gjejmë një term më të butë ose më të

përshtatshëm lidhur me këtë formulim. Unë kam një formulim, pra të thuhet: “Ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:

Ushtron drejtpërsëdrejti përgjegjësitë e tij në nivel njësie vendore dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet, punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor”.

Pra, fjala “menjëherë” të zëvendësohet me fjalën “drejtpërsëdrejti”. Besoj se kjo nuk e ndryshon thelbin e asaj që kërkohet të zgjidhet. Po flas nga pikëpamja e formulimit ligjor.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Te neni 11, më vjen keq që nuk e ka kapur relatori, te germa “dh” thuhet: “...Ushtron përgjegjësinë e parashikuar shprehimisht në ligjet e tjera”. Në cilat ligje të tjera? Caktoje se në cilat ligje! Nuk mund ta lësh apriori. Pra, thuhet: “Përgjegjësi i Inspektoratit Kombëtar Ushtron përgjegjësinë e parashikuar shprehimisht në ligjet e tjera”. Kjo është një fjali e përgjithshme. Thuaje se në cilat ligje. Është mirë të saktësohet se në cilat ligje, që të jetë e qartë.

Fatmir Xhafaj – Ju keni të drejtë, por për efekt të teknikës legislative është e vështirë, sepse ndryshohet legjislacioni. Është ndjekur kjo mënyrë, për shkak se ajo mund të jetë një listë që zgjerohet nesër. Nëse e vendos, duhet të ndryshohet edhe ajo pastaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se e ka ligji, do t’i referohet ligjit.

A jeni dakord me ndryshimin e propozuar, zoti Manja? Dakord.

Neni 12. A jeni dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 13. A jeni dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 14. A jeni dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 15.

Ulsi Manja – Te neni 15 shkurtimi IKMT të shkruhet i plotë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet.

Neni 16. A jeni dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 17.

Ulsi Manja – Te neni 17 kemi rënë dakord që te titulli i nenit të hiqet fjala “administrativ” dhe të mbetet thjesht “ankimi gjyqësor”.

Petrit Vasili – Në fund të nenit 17 thuhet: “Në rast se në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati, që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar, por në qoftë se është biznes, edhe fitimin e munguar”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Zonja Ministre, unë kam një pyetje dhe një shqetësim. Lidhur me ankimin, është një kategori personash, të cilëve, në rast se u prishet banesa, pavarësisht se mund ta fitojnë gjyqin më vonë dhe të dëmshpërblehen, janë të dobët dhe nuk kanë mundësi të strehohen. Flas për kategoritë e veçanta që nuk kanë mundësi ekonomike, që nuk përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale dhe që nuk përfitojnë nga banesat sociale për shkak se ato ligje ende nuk janë amenduar. Nëse INUK-u bën veprime dhe atyre nuk u jepet mundësia që të mos u prishet shtëpia pa u ofruar një alternative, ne i bëjmë edhe më shumë vulnerabël, i dëmtojmë ata, sepse vendimi në këtë rast, ankimi gjyqësor nuk e pezullon ekzekutimin. Pra, a është e mundur që për një kategori të veçantë personash që të gjendet një zgjidhje? Ky është merak.

Te neni 35 i ligjit, që kemi kaluar për legalizimet, kemi thënë se nuk prishen banesat po ofruar banesë në zonat që ka investime të pallateve gjashtë kate e lart. Besoj se ju kujtohet neni 35 i rishikuar. Unë dua që të shmangim pikërisht këtë problem dhe kjo duhet bërë pikërisht për këtë kategori personash, të cilët mund të dalin në rrugë të madhe.

Fatmir Xhafaj – Çfarë lidhjeje ka kjo me këtë ligj?

Dashamir Peza – Kam më shumë një kuriozitet. A kemi lënë ne një vakuum të tillë ligjor, pra që ka njerëz që nuk kanë mundësi jetike dhe nuk kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë?

Ermonela Felaj – Ka.

Fatmir Xhafaj – Zonja Ministre, keni fjalën për tri sugjerimet që u bënë.

Ermonela Felaj – Unë jam dakord me sugjerimin e relatorit për të hequr nga titulli i nenit fjalën “administrativ”, sepse edhe Inspektorati Kombëtar, edhe INUK-u nuk kanë organ epror administrativ, kështu që qytetarët do të jenë të detyruar të shkojnë drejtpërsëdrejti në gjykatë për t’u ankuar për vendimet e tyre. Nga ana tjetër, mendoj se ligji vendos parimin dhe parimi është që ndërtimet e paligjshme nuk duhet të justifikohen, sepse duhet që të mos lejohen këto ndërtime.

Për sa i takon shqetësimit të zonjës Vasilika, të cilin e njoh në detaje dhe e di se cilit rast konkret i referohet, mendoj se me një akt tjetër nënligjor mund ta marrin e duhet ta zgjidhin, por nuk mund të jetë objekt i zgjidhjes ky ligj. Ky është parimi, nuk mund të bëjmë tolerancë këtu.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit.

Neni 18.

Dakord.

Neni 19.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Mendimi im për këtë është që akti nënligjor nuk duhet të dalë detyrues, se i vëmë një afat në ligj, por akti nënligjor duhet të dalë si një nevojë e moszbatimit uniform të ligjit në praktikë apo një shqetësimi që sjell praktika gjatë zbatimit të ligjit. Në atë moment Këshilli i Ministrave mund të specifikojë se si zgjidhet kështu problematike. Po të mos ketë asnjë problem në zbatimin e ligjit, atëherë do ta nxjerrë aktin apriori, sepse ia ka dhënë ligji si detyrim. Mendoj se nxjerrja e aktit duhet të vijë si nevojë përveçse si detyrim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 20.

Dakord.

Bashkim Fino – Neni 20, pika 2, mua më duket jokorrekt, sepse themi që “strukturat e Inspektoratit Kombëtar në mbrojtje të territorit miratohen brenda tre muajve të hyrjes në fuqi”. Nuk ka pse e lëmë këtë gjë. Ti i thua ministrit të ri që shiko ke tre muaj kohë të miratohet struktura. Kur t’i ia kalon, ai e miraton menjëherë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Hiqet pika 2. Faleminderit!

Neni 21.

Dakord.

Neni 22.

Dakord.

Neni 23 Hyrja në fuqi. Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Si të mos e votoj?

Pandeli Majko - Shumë e drejtë. 15. Në emër të një grupi jo të vogël deputetësh, te neni 11, ku diskutohet arsimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të shtohet “ dhe arsimi i lartë ushtarak dhe policor”. Keni parasysh që ka një varg veprimesh që kryhen nga inspektimi, sepse është kërkuar shpesh ndihma e ushtrisë, po mendoj se brenda inspektoratit të ketë persona me *backgranud* të natyrave të tilla.

Fatmir Xhafaj – Zoti Qefaliaj.

Xhemal Qefalia – Propozimi i zotit Majko është i bazuar, pasi eksperiencia e ka treguar se në të gjitha prishjet që janë bërë, janë përdorur ushtarakët. Ata janë inxhinierë të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë dhe ata duhet të jenë patjetër të pranishëm.

Vasilika Hysi - Në vazhdim të diskutimit të kolegut Qefalia, lidhur me “funksionet e inxhinierëve”, po të kemi parasysh llojet e ndërtimeve pa leje që po bëhen, nuk janë ndërtesa, por kemi edhe abuzime me shtretërit e lumenjve, dëmtime masive të pyjeve, dhe duke thënë ju “inxhinier ndërtimi” dhe lini jashtë specialistë pyjesh, ne e kufizojmë shumë dhe do të detyrohet INUK-u të kërkojë ndihmën e specialistëve të tjerë. Prandaj, kur vijmë te inxhinieria, të kemi parasysh të gjitha llojet e ndërtimeve pa leje. Madje, do t’i thosha zonjës ministre që INUK –u rast pas rasti, kur të ketë nevojë për një specialist të veçantë, ta lini pjesën e inxhinierisë më të lirë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Nëse ushtarakët e lartë dhe policët e lartë janë të specializuar, jo të kenë thjesht shkollën ushtarake, por të specializuar, se nuk ka se çfarë na duhet inspektor në xhenio vetëm me shkollë ushtarake. absolutisht duhet të futen dhe nuk kanë pse të mungojnë këtu.

Këtu janë futur edhe inxhinierë transporti, po ç’lidhje ka ai me prishjen? Ky nuk duhet fare para një inxhinieri të xhenios, për shembull inxhinier transporti drejtori i INUK-t. Kjo nuk bën. Unë jam dakord me propozimin e zotit Majko “ të jenë të specializuar”.

Fatmir Xhafaj – Zoti Klosi.

Blendi Klosi – Më vjen keq që do të jem kundër një grupi të madh deputetësh, por që janë këtij propozimi, por mendoj se kryeinspektori nuk mund të jetë pa arsimin përkatës, prandaj në mbështetje të propozimit të një grupi të madh deputetësh të ketë një ndarje,

kryeinspektori të jetë me arsim të specializuar për fushat e përmendura dhe inspektorët ta kenë hapësirën më të gjerë. Prandaj ndarja e kryeinspektorit nga inspektorët mendoj se nuk e zgjidh problemin.

Fatmir Xhafaj – Zonja Ministre.

Ermonela Felaj - Këtu dy ndryshime kemi bërë, e para, kemi hequr mundësinë që në inspektorate vendore të jenë edhe me shkollë të mesme, por kemi kërkuar që të jenë të gjithë me shkollë të lartë. Ndryshimi i dytë është që kemi shtuar si profesion drejtësinë, që nuk ka qenë në ligjin aktual.

Personalisht nuk do të isha dakord për të gjithë ushtarakët. Mos ta keni këtë merak se këto nuk kanë statusin e nëpunësit civil.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

I ke hidro, i ke mjedis.

Fatmir Xhafaj – Unë jam dakord me propozimin që e specifikon qartë edhe zoti Qefalia dhe e mbështeti zoti Fino. Duke i ndarë në kryeinspektorë dhe inspektorë, që të mos ketë abuzime me kryeinspektorin.

Biem dakord kështu?

Dakord. Miratohet me ndryshimet.

MBLEDHJA MBYLLET